# UDHEZUES PER QYTETARET

**Udhëzues dhe Fletëpalosje për Qytetarët (çfarë është QV, procesi i vendimmarrjes së KB, procesi i konsultimit të buxhetit nga këshilli me qytetarët, etj)**

Cfare eshte Qeverisja Vendore?

Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizmit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetë qeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik.

Në përputhje me Kartën Evropiane të Autonomisë lokale, me autonomi vendore kuptohet e drejta dhe aftësia efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsive të tyre, një pjese të mirë të çështjeve publike. Kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat apo asambletë e përbëra nga anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal dhe që mund të kenë organe ekzekutive përgjegjës para tyre. Kjo dispozitë nuk i pengon qytetarët të mblidhen në kuvende, referendume apo çdo formë tjetër të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre aty ku lejohet nga ligji.

Këshilli Bashkiak, si ogani përfaqësues i qeverisë bashkiake ka tre role kryesore: 1- përfaqësues, 2- vendimarrës dhe 3- mbikqyrës. Qeverisja bashkiake përfaqësuese dhe demokratike kërkon që Këshilltarët Bashkiakë të jenë të pavarur, të paanshëm dhe të përgjegjshëm ndaj banorëve, zgjedhësve territorit të juriksionit të vendimmarrjes së tyre; që vendimet dhe politikat e Këshillit Bashkiak të bëhen në interes të komunitetit dhe territorit të Bashkisë.

1. Këshilli Bashkiak, përveç kompetencave të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore, miraton edhe[1]:
    a. drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme publike në fushën e financave të njësisë;
    b. prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore;
    c. miraton politikat e zhvillimit territorial të Bashkisë;
    d. vendos për taksat e tarifat vendore, sipasLigji139/2015 dhe legjislacionit tjetër në fuqi, dhe rishikon politikat fiskale vendore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;

[1] (referencë Ligji 139/ 2015, neni 54; Ligji 68/2017, neni 6)

e. programin buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
f. buxhetin vjetor të Bashkisë dhe ndryshimet e tij, në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
g. vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe marrjen e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të Bashkisë.
h. miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
i. miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
j. miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
k. organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
l. vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
m. vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
n. miraton vendime për masat për mbrojtjen e tokës bujqësore.[2]
o. propozon shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë[3].

2. Këshilli nuk mund t'i delegojë kompetencat e tij në favor të organeve kryesuese të Këshillit, si Kryetarit dhe Kryesisë së Këshillit[4], apo

3. Këshilli nuk i delegon kompetencat e tij të tretëve, përveç se kur kërkohet me ligj.

### *Procesi i vendimmmarrjes së Këshillit*

1. Vendimet e Këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të rastit të permendura në pikat 1 e 3 më poshtë të këtij neni[5].

2. Vendimet e Këshillit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit për rastet kur Këshilli: a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e Këshillit dhe miraton Rregulloren e Brendshme të funksionimit të vet, Kodin e Etikës, Rregulloren për Konsultimin Publik dhe Rregulloren për Zgjedhjen dhe funksionimin e Strukturave Komunitares, rregulloren e trajtimit te peticioneve, ankesave, kerkesave dhe nismave qytetare, rregulloret e sherbimeve; b) zgjedh Kryetarin dhe Zëvendëskryetarët e Këshillit dhe i shkarkon ata; c) emëron dhe shkarkon Sekretarin e Këshillit Bashkiak; d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues; dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij si edhe numrin maksimal të

[2]Ligji nr. 9244/2004, i ndryshuar "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".
[3]Ligji nr. 139/2015, neni 62/c.
[4]Ligji nr. 44/ 2015KPA, neni 28/3.
[5] Ligji nr. 139/2015, neni 54/2.

punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë; e/1) miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private[6]; f) vendos për taksat e tarifat vendore; g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve; gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë; i) zgjedh përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut; j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit[7].

3. Vendimet e Këshillit merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit për rastin kur Këshilli miraton tjetërsimin e pronave bashkiake të tretëve.[8]

## *Buxhetimi vjetor i shpenzimeve të Këshillit*

1. Këshilli Bashkiak harton projektbuxhetin e vet mbi bazë përformance dhe e përfshin çdo vit në linjën e vet buxhetore të buxhetin e Bashkisë, si dhe përcakton shpenzimet e veta në mbështetje të aktiviteteve të parashikuata në programin e tij të punës, të standarteve të punës së Këshillit dhe nevoja për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.
2. Në këto shpenzime përfshihen pagat e shpërblimetpër punonjësit e Sekretariatit të Këshillit, të shpërblimeve të Këshilltarëve, fondi i barabartë për secilin Këshilltar për aktivitetine tij si Këshilltare; shpenzimet për informimin dhe transparencën e veprimtarisë së Këshillit;shpenzimet për marrëdhënjet me publikun, pjesëmarrjen e publikut në politikëbërje dhe vendimarrje dhe konsultimet me publikun; për mbështetje teknike e ekspertizë; për rritjen e kapaciteteve të Këshilltarëve dhe Sekretariatit; për shpenzime operative dhe investimet për përmirësimin e kushteve dhe mjediseve të punës; për pjesëmarrje për vizita studimore, në konferenca e aktivitete të ngjashme; shpenzime për aktivitetet e përfaqësimit institucional të Këshillit, dhuratat, pritje të delegacioneve nga këshilla homologë;shpenzimetpër botimet e Këshillit dhe blerjen e botimeve;për rimbursimet për shpenzimet e autorizuara;për anëtarësim në organizata profesionale arpo ku përfaqësohet Këshillit, etj.

## *Miratimi i projektbuxhetit vjetor të Këshillit*

1. Sekretari i Këshillit i dorëzon secilit prej Këshilltarëve një kopje të projekt buxhetittë Këshillit Bashkiak.
2. Miratimi i buxhetit të Këshillit Bashkiak bëhet me votimin “Pro” të shumicës së Këshilltarëve të pranishëm në Mbledhje.Kryetari firmos projektbuxhetin dhe ia përcjell Kryetari të Bashkisë për ta përfshirë në projekt dokumentin e konsoliduar të buxhetit të Bashkisë.

[6] Ligji nr. 38/2019.
[7] Ligji nr. 139/2015, neni 54/3.
[8] Ligji nr. 139/2015, neni 54/4, ndryshuar me Ligjin 38/2019.

3. Kryesia e Këshillit është përgjegjëse për planifikimin dhe ndjekjen e zbatimit të buxhetit të Këshillit. Kryetari i Këshillit autorizon zbatimin, duke përfshirë shpenzime për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme të Këshillit[9]. Sekretari i Këshillit është përgjegjës për administrimin e buxhetit të Këshillitdhe bashkëpunon me administratën e Bashkisë për këtë qëllim.

### *Shqyrtimi i projekt buxhetit afatmesëm dhe vjetor të Bashkisë*

1. Këshilli i Bashkisë e shqyrton dokumentin e buxhetit afatmesëm dhe vjetor të Bashkisë sëpaku në tre mbledhje, ku në Mbledhjen e parë (muaji qershor) Këshilli shqyrton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm, të paraqitur nga Kryetarit të Bashkisë, në Mbledhjen e dytë (muaji shtator) Këshilli shqyrtondokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, ndërsa në mbledhjen e trete (muaji dhjetor) Këshilli shqyrton dokumentin final të projektbuxhetit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bashkë me rekomandimet dhe propozimet e ardhura nga konsultimet me komunitetin dhe grupet e interest.
2. Këshilli miraton ndryshimet në politikën fiskale vendore të taksave dhe tarifave vendore, jo më vonë se 30 ditë pas miratimit nga Këshilli të ndryshimeve në legjislacionin fiskal, me ndikim në të ardhurat e Bashkisë.
3. Këshilli siguron që programi buxhetor afatmesëm vendor përfshin informacionin për pesë (5) vite, vitin e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese, për çdo program buxhetor të Bashkisësi dhe ka të përcaktuar qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse, si dhepër standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe niveli i përmbushjes së tyre[10].
4. Këshilli siguron që të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore[11].
5. Këshilli zbaton kalendarin e procesit të hartimit dhe miratimit të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, si vijon:
    a. Këshilli merr në shqyrtim, jo më **vonë se data 31 janar dhe miraton brënda 1 mars**,**raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave**, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore[12], dhe e miraton raportin jo më vonë se data 1 mars[13].

---

[9]Ligji nr. 68/2017, neni 54/2i.
[10] Ligji nr. 68/2017, Neni 36/4/c, d.
[11] Ligji nr. 68/2017, neni 36/4c.
[12] Ligji nr. 68/2017, neni 34/1.
[13] Ligji nr. 68/2017, neni 34/4.

b. Këshilli merr për shqyrtim **tavanet përgatitore** të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi[14], dhe miraton ato jo më vonë se data **15 mars**[15].

c. Këshilli njihet nga Kryetari i Bashkisë, brenda muajit Maj, me projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm, të cilin Kryetari i Bashkisë ia dërgon brenda datës **1 qershor** Ministrisë së Financave për mendime[16]. Këshilli bën konsultime publike për prioritet e buxhetit, brenda muajit Maj.

d. Këshilli merr për shqyrtimdhe miraton brenda datës **30 qershor** projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe shoqëruar me mendimet e Ministrisë së Financave, duke shprehur gjatë shqyrtimit edhe opinionin e Tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave.Çdo Këshilltar apo grup Këshilltarësh mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë. Ky **projektin e parë** i programit buxhetor afatmesëm **publikohet** nga Kryetari i Bashkisë brenda datës **5 korrik**[17].

e. Këshilli miraton, brenda datës **20 korrik, tavanet përfundimtare** të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm praqitura nga Kryetari i[18] Bashkisë, dhe që bazohen në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave.

f. Këshilli merr për shqyrtim dhe miraton, brenda **datës 10** shtator, dokumentin e **programit buxhetor afatmesëm të rishikuar**, dhe Kryetari i Bashkisë ia dërgon më pas Ministrisë së Financave brenda datës 15 shtator[19] së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë. Pas miratimit të projektit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, Kryetari i Bashkisë përgatit projektbuxhetin vjetor[20].Çdo Këshilltar apo grup Këshilltarësh mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

g. Kryetari i Këshillit në bashkëpunim më Kryetarin e Bashkisë organizojnë, brenda datës **5 tetor**, një **dëgjesë publike të përbashkët me Ministrinë e Financave**. Kryetari i Këshillit, brenda datës 20 tetor, merr mendimet përfundimtare të Ministrisë së Financave (nëse ka), për t'i reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm[21]. Në këtë dëgjesë publike merr pjesë edhe Kryetari i Komisionit të Financave dhe Buxhetit. Njoftimi për dëgjesën publike bëhet nga Sekretari. Këshilli bën konsultime publike për prioritet e programeve buxhetore brenda muajit Tetor.

[14] Ligji nr. 68/2017, neni 34/5.
[15] Ligji nr. 68/2017, neni 34/6.
[16] Ligji nr. 68/2017, neni 35.
[17] Ligji nr. 68/2017, neni 35/8,9.
[18] Ligji nr. 68/2017, neni 37/1.
[19] Ligji nr. 68/2017, neni 38/3.
[20] Ligji 68/2017, neni 40/1.
[21] Ligji 68/2017, neni 38/4.

h. Këshilli merr për shqyrtim nga Kryetari i Bashkisë, brenda datës **30 nëntor**, **dokumentin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe projektbuxhetin vjetor**. Mendimet e Ministrisë së Financave dhe vlerësimi i Kryetari të Bashkisë për marrjen në konsideratë të tyre, paraqiten në një aneks të veçantë të projektit të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar[22]. Çdo Këshilltar apo grup Këshilltarësh mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë. Këto ndryshime duhet të jenë në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara në nenin 5 të Ligjit 68/2017[23].

i. Këshilli, brenda datës **25 dhjetor**, **miraton** dokumentin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe projektbuxhetin vjetor[24]. Gjatë shqyrtimit të projekti final të projekt buxhetit, Këshilli dëgjon edhe komentet e publikut, të cilat pasqyrohën në shtojcën e dokumenti të buxhetit sëbashkue me komentet e marra nga dëgjesat publike dhe dëgjesën e Komisionit të Financave dhe Buxhetit.

j. Kryetari i Bashkisë, brënda datës **31 dhjetor**, bën publikimin edokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor të miratuar, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre në faqen e internetit zyrtare të Bashkisë[25],jo më vonë se 15 ditë pas miratimit nga Këshilli[26].

[22] Ligji 68/2017, neni 39/1; 41/1.
[23] Ligji 68/2017, neni 41/2.
[24] Ligji 68/2017, neni 39/2; 41/3.
[25] Ligji 68/2017, neni 39/3.
[26] Ligji 68/2017, neni 41/6.